

NË NUMRIN E RI TË REVISTËS SPEKTER
18 Tetor 2003 Nr. 134

EDI RAMA: UNË KRYETARI I TIRANËS DERI NË 2009

PERSONAZHI
NUK DO TË BËHESHA KURRË POLITIKAN

PERSONAZHI
ZHAKU: T'ju rrëfej disa sekrete?

KINEMATOGRAFI
LULE TË ZEZA. NJË SKUP DRAMATIK

TENDENCE
TË BUKUR ME ÇDO KUSHT, OPERACIONET PLASTIKE TASHMË LARG TERMIT TABU

LEONARDO VOÇI
Piktori ekstravagant

FATOS KONGOLI
Pse romani im u quajt më i miri.

QUALITET
Nivik apo shtëpi me qira. Si jetojnë studentët shqiptarë dhe kosovarë në metropolin e shtrëjtë

SPEKTAKËL
"Miss Albania" së shpejti edhe në Itali

Vjollca
një mama e trupit të fortë

KESH sh.a.
ZYRA E SHTYPIT DHE E
MARREDHENIEVE ME PUBLIKUN



DISKUTIM ME PUBLIKUN MBI NDIKIMIN NE MJEDIS TE TEC-it TE RI TE VLORES

KESH hap sot diskutimin publik mbi studimin për vlerësimin e ndikimit në mjedis të TEC-it të ri të Vlorës. Siç jeni në dijeni, studimi për ndërtimin e TEC-it të Vlorës ka kaluar në katër faza:

Faza I: Zgjedhja e vendit më të përshtatshëm për ndërtimin e TEC-it

Në përputhje me kontratën ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës, KESH-it dhe kompanisë amerikane "Harza", u studiu se cili do të jetë vendi më i mirë dhe cila do të jetë teknologjia më e mirë për ndërtimin e një centrali të ri (TEC-i) në Shqipëri e më pas u kalua në realizimin e studimit të plotë të leverdisshmërisë ekonomike. U studiuuan, u vlerësuan dhe u rreshtuan, në bazë të kriterëve plotësisht të pracktuara nga Banko Botërore, disa vende ku mund të ndërtohej ky TEC. Studimi u diskutua gjërësisht në shumë takime ndërmjet specialisteve të Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë, KESH-it, Ministrisë së Mjedisit dhe autoriteteve lokale. Në takimin e zgjeruar të datës 31 tetor 2002, autoritetet lokale të Vlorës, NGO-së dhe intelektualë të Vlorës deklaruan se falenderojnë Ministrinë e Industrisë dhe Energjetikës dhe KESH-in për procedurat transparente të trajtimit të këtij projekti me rëndësi madhore për vendin. Bazuar në këtë analizë të thellë, në takimin e KRRT -së së qarkut të Vlorës, më 23 dhjetor 2002, u aprovua unanimisht që TEC-i të ndërtohet në vendin e quajtur "Vlora B" (zona pranë Portit të Ri). Në mbledhjen e KRRT-së së Republikës së Shqipërisë më 19 shkurt 2003 u pranua nga të gjithë anëtarët e këtij Këshilli, ndërtimi i TEC-it në zonën "Vlora B".

Faza II: Leverdisshmëria ekonomike e TEC-it të Vlorës

Raporti final i fisibilitetit u përfundua dhe u prezantua në Vlorë më 21 shtator 2002. Në të sigurohet një panoramë e përgjithshme e teknologjisë së zgjedhur dhe teknologjia e propozuar është ajo e ciklit të kombinuar. Fuqia optimale për ndërtimin e këtij TEC-i mbi bazën e koston minimale rezultoi 135 MW dhe investimi përkatës 105 milionë USD duke përfshirë edhe investimet përkatëse të infrastrukturës.

Faza III: Studimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis për TEC-in e Vlorës

Në takimin e datës 3 prill 2003, në takimin e zgjeruar të Vlorës, në të cilin morën pjesë KESH-i, Ministria e Industrisë dhe Energjetikës, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Agjencia Kombëtare e Energjisë, Ministria e Mjedisit, autoritetet lokale të Vlorës, NGO dhe intelektualë të Vlorës, u prezantuan Termat e Referencës mbi bazën e të cilave do të realizohet gjatë periudhës prill - shtator 2003, studimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM). Në këtë takim, specialistët e Ministrisë së Mjedisit deklaruan se falenderojnë kompaninë "Harza", MJE-in, KESH-in, AKE-n për procedurat transparente të trajtimit të këtij projekti me rëndësi madhore për vendin. Kjo, theksuan ata, është në linjë me Ligjin shqiptar të Mjedisit dhe Konventën e Arhusit (Danimarkë), sipas së ciles, përpara se të fillojë një studim i vlerësimit të ndikimit në mjedis duhet që Termat e Referencës t'i bëhen të njohura të interesuarve dhe komunitetit lokal në të cilin do të ndërtohet ky objekt.

Që më 23 korrik 2003, Ministria e Industrisë dhe Energjetikës e KESH-i dërguan në Vlorë draftin e vlerësimit të ndikimit në mjedis për sugjerime dhe komente nga ana e komunitetit. Në qarkun e Vlorës u dorëzuan 20 kopje në shqip dhe pesë kopje në anglisht të materialit të plotë. Një kopje në shqip dhe në anglisht iu dërgua gjithashtu edhe Ministrisë së Mjedisit. Kjo u bë komform zbatimit të Konventës së Arhusit, të cilën, Kuvendi i Shqipërisë e ka ratifikuar.

Më 3 shtator 2003, MJE-ja, KESH-i, Agjencia Kombëtare e Energjisë dhe kompania "Harza" paraqitën draftin e studimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis përpara Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministrisë së Mjedisit, autoriteteve lokale të Vlorës, NGO-së dhe intelektualëve të Vlorës.

Në këtë takim u përshkrua në detaje niveli i emetimeve, që do të hedhë në atmosferë ky TEC. Konkluzioni final i analizës ishte që emetimet e SO₂, CO, NO_x, PM10 (grimcave të ngurta 10 mikroneshe) janë 5-8 herë më të vogla se normatival shqiptare, të Bankës Europiane të Investimeve, Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Bankës Botërore. Tre bankat janë njëkohësisht edhe finoncuesit e këtij projekti me fuqi rreth 135 MW dhe investim 105 milionë USD. Duhet theksuar se emetimet e TEC-it janë më të vogla se emetimet e lejuara në bazë të normave shqiptare (në bazë të ligjit Nr. 8934 datë 05.09.2002). Për pasojë, emetimet nga TEC-i janë 5-8 herë më të ulta se normat e ligjit të mësipërm. Ky konkluzion është me një rëndësi të madhe, sepse i jep dritën jeshile ndërtimit të TEC-it. Gjithashtu, ndodhet e ujit, për shkak të teknologjisë së zgjedhur, janë të papërfillshme. Rritja e temperaturës së ujit të detit do të jetë 1.77 °C më e vogël se 3 °C që është normativa e BEI-it, BERZH-it dhe Bankës Botërore. Në këtë studim, gjithashtu paraqitet edhe Plan i Menaxhimit dhe Monitorimit të Mjedisit si gjatë fazës së ndërtimit të TEC-it ashtu edhe shfrytëzimit të tij. Në takim, studimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis u vlerësua maksimalisht nga ana e të pranishmëve dhe iu kerkuan MJE-s dhe KESH-it që të shpejtojnë procedurat për të bërë të mundur fillimin sa më shpejt që të jetë e mundur të ndërtimit të këtij TEC-i.

Siç u theksua më sipër, studimi mbi ndikimin në mjedis ka përfunduar; është miratuar nga institucionet shqiptare dhe së fundi ka marrë edhe aprovimin nga Qeveria shqiptare. Bazuar në standartet ndërkombëtare, ftojme të gjithë të interesuarit që të marrin pjesë në konsultimin e gjërë publik të studimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga ana e TEC-it të ri të Vlorës. Për dijeninë tuaj, ju njoftojmë se studimi në gjuhën angleze dhe të përkthyer në shqip, ndodhet në këto tre adresa:

- | | | |
|--|--|---|
| 1. KESH sh.a.
Zyra e Shtypit dhe e
Marredhënieve me Publikun
Blloku "Vasil Shanto", Tiranë
Tel: 04 259 728 | 2. Agjencia Kombëtare e
Energjisë
Rr. "Sami Frasher" Nr. 33
Tel: 04 271 559 | 3. Qarku i Vlorës
Sheshi "4 heronjtë"
Tel: 033 22 635 |
|--|--|---|

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a.
Tel. +355 4 232 046 Fax. +355 4 232 046
Adresa: Blloku "Vasil Shanto", Tiranë, E-Mail: mail@kesh.com.al

ARMO Albanian Refining and Marketing of Oil
Sh.a. Lagja "1 Maj" Fier - Albania

Njoftim për vend të lirë pune

Shoqëria ARMO sh.a më e madhja në vend për përpunim dhe tregëtimin e karburanteve dhe shtrirjen e saj gjeografike, kërkon të punësojë:

AUDITË TË BRENDSHËM (Ish kontroll financiar)

Kandidatët do të nënshrohen konkursit i cili do të zhvillohet në dy faza.
Në fazën e parë që është ajo kualifikuese ata do të paraqesin këto dokumenta:

Fotokopje të noterizuar të:

1. Diplomës (Ekonomist, Jurist)
2. Lista e notave
3. Librezë pune
4. Dëshmi e gjuhëve të huaja (nëse ka)
5. Dëshmi përdorimi të kompjuterit (nëse ka)
6. Rekomandim nga punëdhënësi i fundit (origjinal)
7. Certifikatë të kualifikimeve pasuniversitare (në rast se ka)
8. Raport mjekësor për aftësi në punë (origjinal)
9. Curriculum Vitae i detajuar
10. Dëshmi penalitetit, vërtetim gjykatë dhe prokurorie(origjinale).

Në fazën e dytë që është konkursi i kandidatët do të testohen dhe vlerësohen sipas kriterëve të cilat mund të gjeni pranë kompanisë ARMO sh.a. për çdo nga data 15.10.2003-21.10.2003 dhe nga ora 7:00-15:00 me adresë Lagja "1 Maj" Fier.

Me kriteret do të jetë e saktësuar edhe data e zhvillimit të konkursit që paraprakisht është data 22.10.2003.

Dokumentat do të fërhiqen nga kandidatët pranë sekretarisë kundrejt një kërkesë në të cilën do të jetë përcaktuar adresa e saktë dhe numri i telefonit.

Për informacion më të plotë mund të telefononi në numrat 034 23931 ose 0962036143